

## Kombetarja arrin ne Marseje

nga Administrator

E martë, 14 Qershor 2016 15:42

---



Kombetarja Shqiptare ka arritur sot ne qytetin e Marsejes, ku neser ne oren 21:00 do te ndeshet kunder ekipit te Frances. Pas humbjes kunder Zvicres, lojtaret e kombetares jane stervitur seriozisht ne menyre qe te bejne nje paraqitje sa ma dinjitoze kunder ekipit vendas qe cilesohet si nje nder pretendetet kryesor per fitimin e trofeut. Ekipi eshte nisur sot paradite me charter per ne Marseje. Ne oren 19:45 do te mbahet konferenca per shtyp ne prag te ndeshjes kunder Frances, kurse ne oren 20:30, ne stadiumin Velodrome, kombetarja do te zhvilloje seancen stervitore.